



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 177

Tiranë – E premte, 23 shtator 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 85/2016 datë 8.9.2016	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 29.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”..... 20589
Ligj nr. 86/2016 datë 8.9.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe qeverisë së Republikës Italiane, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, për realizimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe projektimit në nivel përfundimtar, si dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave..... 20589
Ligj nr. 87/2016 datë 8.9.2016	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Peizazheve..... 20605
Vendim i Kuvendit nr. 59/2016, datë 8.9.2016	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës..... 20609
Vendim i Kuvendit nr. 60/2016, datë 8.9.2016	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës..... 20610



**LIGJ**  
Nr. 85/2016

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,  
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË  
29.7.2016, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME  
NË LIGJIN NR. 147/2015, “PËR  
BUXHETIN E VITIT 2016””**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 29.7.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016””.

Miraturar në datën 8.9.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9745, datë 16.9.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
Nr. 86/2016

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE  
INFRASTRUKTURËS, DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS ITALIANE, TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
PUNËVE TË JASHTME DHE  
BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR,  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR  
PËRGATITJEN E STUDIMEVE TË  
FIZIBILITETIT DHE PROJEKTIMIT NË  
NIVEL PËRFUNDIMTAR, SI DHE  
STUDIMIN E IMPAKTIT MJEDISOR NË  
SEKTORIN E INFRASTRUKTURAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe qeverisë së Republikës Italiane, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, për realizimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe projektimit në nivel përfundimtar, si dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.9.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9746, datë 16.9.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS  
ITALIANE TË PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE  
BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR PËR  
REALIZIMIN E “PROGRAMIT PËR  
PËRGATITJEN E STUDIMEVE TË  
FIZIBILITETIT DHE PROJEKTIMIT NË  
NIVEL PËRFUNDIMTAR, SI DHE  
STUDIMIN E IMPAKTIT MJEDISOR NË  
SEKTORIN E INFRASTRUKTURAVE”**

Duke pasur parasysh, që:

- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe qeveria e Republikës Italiane, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim”, që të dyja më poshtë do të quhen “Palët”, kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje (që më



poshtë do të quhet “Marrëveshja”);

- Ndër nismat e programuara, Protokollin e Bashkëpunimit Italo-Shqiptar, 2010–2012, përfshin një fond financiar (*project facility*) prej 3 milionë eurosh për studime parafizibiliteti/fizibiliteti, për projektim në nivel përfundimtar dhe studim të impaktit mjedisor, për ndërhyrje që synojnë fuqizimin e rrjetit rrugor shqiptar;

- Si rezultat i negociatave me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë, u ra dakord për të aktivizuar financimin e lartpërmendur për projektimin përfundimtar dhe Studimin e Impaktit Mjedisor, për:

- realizimin e *By Pass*-it të Elbasanit;

- zgjerimin e rrugës aktuale që shkon nga Miloti në Shkodër;

- realizimin e lidhjes direkte nga Vaqarri (periferia e Tiranës) në Kavajë.

- nga analizat e përshtatshmërisë tekniko-ekonomike të bëra nga kjo njësi teknike lokale, për të tria nismat e lartpërmendura dhe për asistencën teknike nga personel italian që punon në Shqipëri dhe nga personel shqiptar ka rezultuar e mjaftueshme shuma prej 2.100.000,00 eurosh.

- në mbledhjen e datës 8 qershor 2012 Komiteti Drejtues i Bashkëpunimit për Zhvillim i Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane, ka shprehur mendim të favorshëm për dhënien e një kredie të butë prej 2.100.000,00 eurosh, për projektimin përfundimtar dhe Studimin e Impaktit Mjedisor për tre sektorë rrugorë:

- realizimin e *By Pass*-it të Elbasanit;

- zgjerimin e rrugës aktuale që shkon nga Miloti në Shkodër;

- realizimin e lidhjes direkte nga Vaqarri (periferia e Tiranës) në Kavajë.

Përveç aktiviteteve të asistencës teknike, për sa më sipër,

Palët kontraktuese bien dakord si më poshtë:

Neni 1

### **Përmbajtja dhe përkufizimet e marrëveshjes**

1.1 Marrëveshja përbëhet nga 15 nene dhe nga bashkëlidhjet e mëposhtme:

Bashkëlidhja 1 – Përmbledhje e programit

Bashkëlidhja 2 – Kriteret e pjesëmarrjes, klauzolat etike, parimet e përgjithshme të kontratave.

Bashkëlidhja 3 – Plani i financiar

Bashkëlidhja 4 – Mënyrat e ekzekutimit dhe të administrimit të kredisë ndihmëse

1.2 Bashkëlidhjet e lartpërmendura janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e Marrëveshjes.

1.3 Fjalët dhe shkurtime të përmendura këtu, më poshtë në tekst kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Marrëveshja”, Marrëveshja aktuale ndërmjet Palëve për vënien në jetë të programit.

“Ambasada italiane”, Ambasada Italiane në Tiranë.

“Marrëveshja financiare”, Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Financave Shqiptare dhe administratorit të kredisë,

“AT” Asistenca teknike e dhënë në kuadër të programit.

“Donator”, qeveria italiane.

“GFR”, Administratori i kredisë: institucioni financiar italian, i cili menaxhon në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Italiane, kredinë e butë të parashikuar në Marrëveshje.

“Linja e kredisë”, kjo kredi e butë për financimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë Program, e rregulluar nga klauzolat e kësaj marrëveshjeje.

“Palët”, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe qeveria e Republikës Italiane, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar italian – Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim.

“MPJBN–DPBZH”, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Italian – Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim.

“MTT”, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Shqipërisë.

“MFSH”, Ministria e Financave Shqiptare.

“Programi”, Tërësia e ndërhyrjeve të parashikuara dhe të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

“SIM”, Studimi i impaktit mjedisor.

“NJTC”, njësi teknike qendrore e MPJBN–DPBZH-së.

“NJTL”, njësi teknike lokale e Ambasadës Italiane në Tiranë.

Neni 2

### **Qëllimi i marrëveshjes**

2.1 Kjo Marrëveshje synon të disiplinojë zbatimin, administrimin dhe përgjegjësitë e Palëve për vënien në punë të programit të quajtur “*Project Facility*” për studime fizibiliteti, projektimi në nivel



përfundimtar dhe për studim të impaktit mjedisor në sektorin infrastrukturor”, që më poshtë do të quhet “Programi”.

2.2 Për këtë qëllim Marrëveshja sanksionon angazhimin e të dyja Palëve në respektim të Programit, duke u kushtuar kujdes të veçantë afateve dhe kushteve për përdorimin e kredisë përkatëse.

Neni 3

### **Përshkrimi i programit**

Programi, përmbledhja e të cilit është paraqitur në bashkëlidhjen 1, synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë për përmirësimin e qarkullimit përgjatë boshitit veri–jug dhe lindje–perëndim dhe të përforcojë fuqinë e zhvillimit ekonomik në drejtim të boshitit Mal i Zi dhe Evropë Veriore; si dhe të kontribuojë në intensifikimin e shkëmbimeve tregtare me Malin e Zi, me të gjithë zonën e Ballkanit dhe me Evropën.

- Objektivi specifik është t'i japë MTI-së tri studime fizibiliteti dhe projektimi në nivel “përfundimtar” dhe studim të impaktit ambiental - pra i tenderueshëm, për tri veprat e mëposhtme infrastrukturore: i) fuqizimin e aksit rrugor me drejtim nga Miloti në Shkodër; ii) krijimin e lidhjes me drejtim nga Vaqarri në Kavajë; dhe iii) krijimin e *By Pass*-it të Elbasanit.

Neni 4

### **Angazhime të qeverisë italiane**

Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga MPJBN–DPBZH-ja, angazhohet të financojë Programin duke vënë në dispozicion një shumë prej 2.100.000,00 eurosh, kredi e butë, që do t'i vihen në dispozicion Administratorit të kredisë dhe do të jepet siç përshkruhet me hollësi në bashkëlidhjen 3 dhe 4.

Neni 5

### **Angazhime të qeverisë shqiptare**

Qeveria shqiptare angazhohet:

5.1 Të garantojë realizimin e Programit në përputhje me Marrëveshjen. Për këtë qëllim do të jetë përgjegjëse për supervizionin e aktiviteteve dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe angazhimet fillestare të përcaktuara në kuadrin

logjik të Programit, siç paraqitet në bashkëlidhjen 1 të kësaj Marrëveshje-je.

5.2 Të verë në dispozicion burimet financiare të ekspertizës, baras me 420.000,00 euro.

5.3 Të bëjë operative të gjitha veprimet, aktivitetet dhe aktet formale të domosdoshme për realizimin e mirë të Programit;

5.4 T'i ofrojë bashkëpunim MPJBN–DPBZH-së për aktivitetet e monitorimit të Programit, edhe për aksesin në dokumentacionin ekzistues;

5.5 Të rimbursojë shumat e marra me kredi të butë, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 8;

5.6 Të financojë, pas projektimit përfundimtar dhe miratimit nga ana e organeve kompetente, ndërtimin e pjesëve të rrugës në fjalë të parashikuara nga Programi.

5.7 Si pasojë e rezultateve pozitive të studimit të fizibilitetit, qeveria shqiptare angazhohet në aktivizimin, pas projektimit përfundimtar dhe miratimit nga ana e organeve kompetente, e procedurave të nevojshme për shpronësimin e tokave që do të përcaktohen në planet e shpronësimit, të parashikuara nga Programi i financuar nga Italia.

Neni 6

### **Strukturat e administrimit dhe realizimit të Programit**

Struktura administruese dhe mënyrat e realizimit të Programit, ashtu siç janë paraqitur me hollësi në bashkëlidhjet 1 dhe 2, parashikojnë:

6.1 Që MTI-ja, Enti ekzekutues i Programit do të përcaktojë marrëveshjet e nevojshme me entet kompetente, do të nënshkruajë kontratat e kërkuara dhe do të jetë përgjegjëse për përdorimin e fondeve dhe të kredisë së butë sipas mënyrave dhe procedurave të përcaktuara nga Marrëveshja Financiare; MTI-ja do të ngrejë një njësi teknike e cila do të jetë operative gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit, dhe do të ngarkohet për zbatimin dhe menaxhimin e Programit, duke garantuar respektimin e procedurave të përcaktuara në Marrëveshje.

6.2 Që MFSH-ja do të nënshkruajë Marrëveshjen financiare;

6.3 Që MPJBN–DPBZH-ja do të garantojë livrimin e burimeve financiare me kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga normativa italiane në fuqi, që është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë Marrëveshje. MPJBN–DPBZH-ja, në



bashkëpunim me MTT-në do të ketë, gjithashtu, detyrën të monitorojë ecurinë e Programit. MPJBN–DPBZH-ja do të operojë me anë të zyrave përkatëse për përmbushjen e detyrave të veta. Në veçanti, njësia teknike qendrore e MPJBN–DPBZH-së dhe njësia teknike lokale, do të garantojnë të gjitha funksionet me natyrë teknike në mbështetje të Programit;

6.4 Që Administratori i kredisë, sipas udhëzimeve të MPJBN–DPBZH-së dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane, do të nënshkruajë me Ministrinë e Financave Shqiptare një Marrëveshjeje Financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së butë. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Financiare, Administratori i kredisë do të kujdeset për ngarkimin e kontratave të veçanta për livrimin e shërbimeve nëpërmjet të cilave do të realizohen aktivitetet e parashikuara në Program. Gjithashtu, do të jetë Administratori i kredisë që do të kujdeset për t'u siguruar organizmave realizues pagesën e shumave përkatëse kontraktuale;

6.5 Që Ambasada/njësia teknike lokale në Tiranë do të garantojë të gjitha funksionet me natyrë teknike të nevojshme për të garantuar ecurinë korrekte të aktiviteteve. Në kuadër të funksioneve të veta institucionale, Ambasada/njësia teknike lokale do të sigurojë, gjithashtu, kontaktet e nevojshme me palët e tjera të Programit, duke u kujdesur, ndër të tjera, për marrjen dhe transmetimin e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Neni 7

### **Mënyrat e përdorimit të kredisë ndihmëse dhe procedurat e vlerësimit**

Në bazë të procedurave në fuqi të MPJBN–DPBZH-së, hapat kryesorë për t'u ndjekur, për përdorimin e fondit si kredi ndihme, janë si më poshtë:

7.1 Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje projekti që përmbledh përmbajtjet e propozimit të financimit, cakton angazhimet e palëve në realizimin e ndërhyrjes dhe vazhdimin përkatës operativ;

7.2 Dhënien nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane, me propozim të MPJBN-së, të një vendimi ministerial që autorizon administruesin e kredisë. Administratori i kredisë, të negociojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me MFSH-në;

7.3 Nënshkrimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Administratorit të kredisë dhe MFSH-së dhe përfundimin, nga pala shqiptare, të të gjitha procedurave të nevojshme, nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare;

7.4 Përgatitjen e dokumenteve të të tre tenderave për besimin e shërbimeve inxhinierike (projektimi përfundimtar i tre sektorëve rrugorë) nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të Shqipërisë, nëpërmjet mbështetjes dhe ndihmës teknike të financuar nga kredia e ndihmës;

7.5 Verifikimi i përputhshmërisë së dokumentacionit të përmendur në pikën 7.4 nga ana e MPJBN–DPBZH-së, dhe në rast rezultati pozitiv, shpallja e tenderave në të njëjtën kohë me publikimin e Dosjeve të Tenderave në Itali (në ngarkim të MPJBN–DPBZH-së), dhe në Shqipëri;

7.6 Vlerësimin e ofertave të mbërritura, nga ana e Komisionit të Tenderit, të ngritur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Shqiptare dhe shpalljen e fituesit të tenderit për shërbimet inxhinierike, me klauzolën pezulluese;

7.7 Verifikimin e përputhshmërisë nga ana e MPJ–DPBZH-së, të procedurave të ndjekura për seleksionimin dhe kontratave që do të lidhen dhe, në rast rezultati pozitiv, nënshkrimin e secilës prej tre kontratave të shërbimit nga ana e Ministrisë kompetente të Transportit dhe Infrastrukturës;

7.8 Ngarkimin nga ana e palës italiane, në Marrëveshjen Financiare, të kontratave të veçanta, të nënshkruara dora-dorës.

Shpallja e fituesit të shërbimeve inxhinierike për realizimin e Programit, do të bëhet me anë të realizimit të tenderave që do të disiplinohen nga dispozitat që përmban Manuali i procedurave (PRAG i zbatuar nga Komisioni Evropian – versioni 2014 me anekset përkatëse në lidhje me dokumentet e garës për shërbime dhe furnizime), me përjashtim të pjesës që lidhet me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën, e cila do të përshtatet me specifikat e kredisë së butë italiane: “Tender shërbimesh, në kuadër të bashkëpunimit të Komunitetit Evropian me vendet e treta”, si edhe nga sa është saktësuar në bashkëlidhjen 2. Shpenzimet në vend mund të kryhen deri në një vlerë maksimale prej 35% të vlerës së kredisë.



Neni 8

### Kushtet financiare dhe mënyrat e livrimit të kredisë së butë

Burimet financiare për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në Program shkojnë në total në 2.100.000,00 euro, si kredi e butë; qeveria shqiptare do të verë në dispozicion një shumë shtesë të barabartë me 420.000,00 euro, që i korrespondon 20% të shumës së nismës, për mbulimin e kostove për TVSH-në dhe taksat, nëse duhen, në bazë të skemës së mëposhtme:

Kredia e butë do të jepet me kushte financiare të tilla që të parashikojnë një përqindje koncesioni (*grant element*) të barabartë me 60% dhe një përqindje zgjidhjeje të barabartë me 2% të shumës së përgjithshme. Afatet dhe kushtet e kredisë së butë do të jenë:

- periudha e rimbursimit: 26 vjet
- periudha e garancisë (për rimbursimin e kredisë): 16 vjet
- interesi: 0% në vit

Në bazë të procedurave në fuqi të MPJ-DPBZH kredia e butë do të jetë e disponueshme pas eksperimentimit të tri procedurave të veçanta të tenderit, për të tre sektorët rrugorë ashtu siç janë përshkruar në nenin 3 të mësipërm.

Në bazë të lidhjes së mëvonshme të kontratave me ndërmarrjet fituese, livrimi i pagesave për shërbimet e inxhinierisë do t'i bëhet drejtpërsëdrejti vetë ndërmarrjeve nga Administratori i kredisë me këste sipas mënyrave të përshkuara në kontratë, të paraqitura në bashkëlidhjen 4, seksioni III, si më poshtë:

Mënyrat e livrimit të kredisë do të jenë si më poshtë:

- 20% e shumës së kontratës, me aprovim të MTI-së, me fillimin e marrëdhënieve të projektimit;
- 30% e shumës së kontratës, me aprovim të MTI-së, të projektit paraprak;
- 30% e shumës së kontratës, me aprovim të MTI-së, të projektit përfundimtar dhe të planit grafik e përshkruar të shpronësimeve;
- 20% e shumës së kontratës, me aprovim të MTI-së, të projektit komplet dhe të teknikave specifike dhe specifikimeve, dhe dokumentet e tenderit për realizimin e veprave të projektuara.

Sasia e shumës së parashikuar për veprimtarinë e njësisë teknike në MTI, për një total prej 150.000,00 eurosh, përcaktuar në zërin Rif. 4a dhe

4b të bashkëlidhjes 3, do të livrohet me kërkesë Administratorit të kredisë nga MTI-ja, në një kësht të vetëm, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Financave dhe Administratorit të kredisë. MTI-ja angazhohet t'i nisë një raport Ministrisë së Punëve të Jashtme, Bashkëpunimi Ndërkombëtar, dhe Administratorit të kredisë, për përdorimin e kësaj shume dhe shpenzimeve përkatëse.

Neni 9

### Aktiviteti i monitorimit dhe kontrollit

Palët angazhohen të vënë në zbatim sa është e nevojshme për arritjen e objektivave të Programit, dhe të kryejnë një monitorim dhe një kontroll të vazhdueshëm për përdorimin e fondeve dhe për çdo kusht tjetër të përmendur në Marrëveshje. Në veçanti, arritja efektive e objektivave do të vlerësohet periodikisht në lidhje me skemën e treguesve që përmban kuadri logjik.

Për përmbushjen e aktiviteteve të parashikuara nga Marrëveshja, MTI-ja do të ngrenë një njësi teknike të përbërë nga personel italian dhe shqiptar zgjedhur për këtë qëllim, si parashikohet në bashkëlidhjen 4 të kësaj Marrëveshjeje. Kostoja për veprimtarinë e njësisë teknike për realizimin e iniciativës është 150.000,00 euro dhe do të përfshihet në kuadër të kredisë së butë.

Neni 10

### Klauzola antikorrupsion

Qeveria e Republikës Italiane është e angazhuar në luftën kundër korrupsionit, në të gjitha shfaqjet e tij. Në veçanti, me qëllim për të shmangur çdo rast aktiviteti të paligjshëm dhe parregullsi në rastin e paraqitjeve të ofertave për furnizime, shërbime dhe punime publike, qeveria italiane ka futur detyrimin për të gjithë pjesëmarrësit në tendera të nënshkruajnë dhe të paraqesin aneksin *Integrity Pact* bashkë me ofertat e tyre apo me kontratat e miratuara. Mosparaqitja e dokumentacionit të lartpërmendur do të përbëjë përjashtim automatik nga tenderi ose do të jetë arsye për të aplikuar sanksionet përkatëse të *Integrity Pact* në rast mosrespektimi të angazhimeve antikorrupsion gjatë zbatimit të kontratës. Futja e kësaj klauzole synon të sigurojë një konkurrencë korrekte dhe mundësi të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit, si edhe një zbatim korrekt dhe transparent të kontratës së aprovuar.



Do të jetë nën vëmendjen e qeverisë italiane të verifikojë përdorimin e *Integrity Pact* me kujdesin maksimal si në lidhje me pjesëmarrësit, ashtu edhe në lidhje me personelin, me bashkëpunëtorët dhe konsulentët.

## Neni 11

**Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë implementimit të Programit duhet të zgjidhen në rrugë miqësore më anë të konsultimit ndërmjet MTI-së dhe MPJBN–DPBZH-së nëpërmjet Ambasadës Italiane.

## Neni 12

**Pengesat dhe forcat madhore**

Në rast pengesash për realizimin e Programit, për shkak të forcave madhore (luftës, përmytjeve, zjarrit, taifunit, tërmetit, konflikteve të punës, grevave, vendimeve të qeverive përkatëse, vështirësive të paparashikuara në transporte dhe shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët ose në rast rreziku apo kushtesh të rrezikshme për personelin e huaj do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

12.1 Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e Programit është më pak se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të paangazhuara do të pezullohet derisa MPJBN–DPBZH-ja të autorizojë rifillimin e aktiviteteve;

12.2 Nëse kohëzgjatja e pengesës është më shumë se gjashtë dhe më pak se njëzet e katër muaj, Programi pezullohet dhe fondet e paangazhuara ruhen deri sa të mos ekzistojë më pengesa dhe sa të merret autorizimi i MPJBN–DPBZH-së për rifillimin e aktiviteteve,

në rast se kohëzgjatja e pengesës do të jetë më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët duhet të bien dakord për vazhdimësinë e Programit dhe të përcaktojnë kursin e veprimeve. Në rast pamundësie për të vazhduar aktivitetet, palët duhet të vendosin për destinacionin e fondeve të paimpënjura. Në mungesë të një marrëveshjeje Pala shqiptare angazhohet të rimbursojë shumat e mbetura të vlejshme mbi fondet e transferuara MTI-së, si parashikohet në nenin 8.

## Neni 13

**Denoncimi i marrëveshjes**

Palët kanë të drejtën të denoncojnë Marrëveshjen në rast se verifikohet një prej rasteve të mëposhtme:

13.1 Mungesa e angazhimit nga ana e qeverisë shqiptare si parashikohet në nenin 5;

13.2 Gabim i rëndë nga ana e MTI-së, si vonesa të pajustificuara dhe të zgjatura (më shumë se nëntë muaj) të tilla sa të kërcënojnë arritjen e objektivit të Programit, përdorim të fondeve për arsye të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe në Marrëveshjen financiare, vonesa të zgjatura në raportet e parashikuara;

13.3 Pengesë e zgjatur në kohë apo forcë madhore, sipas asaj që është përcaktuar në klauzolat e nenit të mësipërm 12;

13.4 Në rast gabimi të rëndë, sipas pikës 13.2, MPJBN–DPBZH-ja duhet t'i njoftojë faktin me shkrim MTI-së, duke e ftuar të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda një periudhe maksimale prej 90 ditësh nga data e njoftimit. Pas këtij afati, MPJBN–DPBZH-ja rezervon të drejtën të denoncojë Marrëveshjen;

13.5 Në dy rastet e tjera të përmendura më sipër, MPJBN–DPBZH-ja mund të vendosë në mënyrë të njëanshme zgjidhjen e Marrëveshjes, duke njoftuar MTI-në me notë verbale të paktën 3 muaj përpara. Në çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MTI-ja duhet të ndërpresë aktivitetet e Programit, me përjashtim të ndonjë marrëveshjeje të ndryshme mes Palëve.

## Neni 14

**Ndryshim i marrëveshjes**

Në çdo moment Palët mund të propozojnë ndryshime në përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje me anë të shkëmbimit të notave verbale, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ndryshimet për të cilat është rënë dakord në këtë mënyrë ndërmjet Palëve do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të brendshme respektive për qëllimin e parashikuar.

## Neni 15

**Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë me të cilin Palët kontraktuese do t'i kenë komunikuar zyrtarisht njëra-tjetrës plotësimin e procedurave përkatëse të brendshme të parashikuara për këtë qëllim.



Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi deri në rimbursimin e plotë të kredisë.

Në mirëbesim, përfaqësuesit nënshkruar, të autorizuar rregullisht nga qeveritë përkatëse, kanë firmosur këtë Marrëveshje.

U hartua në Tiranë, më ....., në dy kopje origjinale, të dyja në gjuhën shqipe dhe italiane.

Në rast mospërputhesh në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën italiane.

Për Këshillin e Ministrave të  
Republikës së Shqipërisë  
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës  
Edmond Haxhinasto

Për Qeverinë e  
Republikës së Italisë  
Ambasadori i Italisë në Tiranë  
Alberto Cutillo

#### BASHKËLIDHJA 1

#### PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Nisma e parashikuar nga Protokoli i Bashkëpunimit për Zhvillim, 2010–2012, synon t'i japë Ministrisë Shqiptare të Transportit dhe Infrastrukturës tri instrumente menjëherë të tenderueshme, për tri veprat e mëposhtme të infrastrukturës:

- Realizimi i *By Pass*-it të Elbasanit;
- Zgjerimin e rrugës aktuale që shkon nga Miloti në Shkodër;
- Realizimin e lidhjes direkte nga Vaqarri (periferia e Tiranës) në Kavajë;

Protokoli i Bashkëpunimit për Zhvillim parashikonte për këtë *project facility* një dhënie fondi prej 3 milionë eurosh. Pala shqiptare ka shprehur mendimin që shuma prej 3 milionë eurosh ishte e përshtatshme për financimin e të tri studimeve të fizibilitetit të lartpërmendura dhe të projektimit përfundimtar. Megjithatë, nga analiza e dokumentacionit të dhënë nga Ministria e Punëve Publike, kostoja e këtyre studimeve të fizibilitetit dhe projektimit përfundimtar ka rezultuar e mbivlerësuar. Pala shqiptare, edhe pse është nxitur disa herë, nuk ka dhënë propozime të tjera plotësuese për të financuar. Prandaj, kredia e ndihmës, e nismës së paraqitur në epigraf është reduktuar në 1.950.000,00 euro, shumë që është menduar si e përshtatshme nga eksperti i

infrastrukturave në një mision të shkurtër pranë Njësisë Teknike Lokale të Tiranës. Kësaj i shtohen 150.000,00 euro për veprimtarinë e njësisë teknike, përcaktuar në nenin 6, prandaj vlera e përgjithshme e kredisë së ndihmës është 2.100.000,00.

#### OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Objektivi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë për përmirësimin dhe për forcimin e planifikimit të rrjetit kryesor rrugor shqiptar gjatë akteve të korridorit VIII dhe të forcojë potencialitetin e zhvillimit social-ekonomik të Shqipërisë dhe të vendeve fqinje, në veçanti, në aksin drejt Malit të Zi dhe Evropës Veriore.

Objektivi i përgjithshëm është në linjë me direktivat e dhëna nga qeverisja qendrore shqiptare, që synon realizimin e një rrjeti rrugor efikas kombëtar që të favorizojë shkëmbimet e personave dhe të mallrave, me vendet kufitare dhe me pjesën tjetër të Evropës, si edhe në brendësi të Shqipërisë, për të përmirësuar rrjetin rrugor ndërmjet pjesës veriore të vendit, që rezulton të jetë një nga më të varftrat, dhe zonave më të pasura dhe të zhvilluara të Shqipërisë ose atyre qendrore ndërmjet Durrësit dhe Tiranës.

Objektivi i përgjithshëm hyn plotësisht edhe në strategjinë e përcaktuar nga Helsinki më 1997, në kuadër të Konferencës së Ministrave Evropianë të Transporteve, për krijimin e 10 korridoreve multimodalë (*Ten Trans European Network*) lidhës ndërmjet vendeve të Evropës Perëndimore dhe atyre të Evropës Lindore dhe hyrës drejt rajoneve përreth Detit Kaspik dhe Azisë Qendrore.

Shkëmbimet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, si edhe me pjesën tjetër të Evropës janë ende shumë të kufizuara, për shkak të rrjeteve të vjetruara të komunikimit dhe për vështirësitë burokratike dhe për vonesat e kontrolleve doganore në kufi.

Objektivi specifik i programit është t'i japë Ministrisë shqiptare të Transportit dhe Infrastrukturës instrumente projektuese, menjëherë të tenderueshme për fuqizimin e qarkullimit të vendit përgjatë drejtimeve veri–jug dhe lindje–perëndim, nëpërmjet tre *facilities* për veprat e mëposhtme të infrastrukturës:

- Dyfishimin e aksit rrugor nga Miloti në Shkodër;
- Krijimin e lidhjes direkte Vaqarri–Kavajë;
- Krijimin e *By Pass*-it të Elbasanit.





Marrja nga ana e qeverisë shqiptare të projekteve në shkallë “përfundimtare”, pra të tenderueshme, do të krijojë mundësinë për një ulje të ndjeshme të afateve për realizimin e tri veprave infrastrukturore të rëndësishme të sipërpërmendura që, pasi të jenë realizuar, do të japin mundësi për: a) uljen e kostove operative të transportit rrugor; b) uljen e kohës së përshkimit të tyre; c) uljen e përqindjes së lartë të aksidenteve; d) rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturave rrugore shqiptare; e) favorizimin e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe të fluksit të mallrave dhe të shkëmbimeve me vendet evropiane, nëpërmjet krijimit të infrastrukturave të reja rrugore dhe fuqizimit e atyre ekzistuese.

#### REZULTATET E PRITSHME

Me qëllim për të përmbushur objektivat e lartpërmendur, duhet të arrihen rezultatet e mëposhtme:

1. Të publikohen tre tendera për shërbimet e inxhinierisë dhe të caktohen fituesit;

2. Të hartohen tri projekte në nivel përfundimtar dhe studimi i impaktit ambiental në lidhje me sektorët rrugorë Milot–Shkodër, Vaqarr–Kavajë dhe *By-Pass*-i i Elbasanit;

3. Të miratohen dhe të vleftësohen tri projektet përfundimtare dhe studimet përkatëse të impaktit ambiental nga ana e qeverisë shqiptare;

#### AKTIVITETET QË SYNOJNË ARRITJEN E REZULTATEVE

Aktivitetet për t'u financuar në kuadër të këtij propozimi mund të përmbliken si më poshtë:

A1 1.1 Përgatitja, nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, e dokumentacionit për tri dosjet e tenderave, që përfshijnë:

Ekstraktin e dosjes së tenderit;

Dosjen e tenderit

Dokumentacionin e strukturuar si më poshtë:

a) Informacione për ofertuesit;

b) Terma referimi;

c) Skema kontrate dhe materiale bashkëngjitur;

d) Dokumentacioni teknik i dhënë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

1.2 Miratimi i dosjeve të tenderit dhe leja për publikimin e tenderave nga ana e entit financues.

1.3 Publikimi i tenderave nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe marrjen e lejes nga MPJBN-ja/DPBZH-ja, për lidhjen e kontratave.

1.4 Caktimin e fituesit të kontratave.

A2 2.1 Hartimin e projekteve përfundimtare dhe studimit të impaktit mjedisor nga ana e shoqërive inxhinierike fituese.

2.2 Verifikimin, nga ana e entit financues, që niveli i projektimit i hartuar, të korrespondojë me atë përfundimtar, si ai i përshkruar në nenin 24 dhe në vazhdim të DPR-së, nr. 207/2010.

A3 3.1 Miratimin dhe vleftësimin zyrtar të MTT-së të projekteve përfundimtare dhe të studimit të impaktit ambiental, të hartuara nga shoqëritë inxhinierike të shpallura fituese.

Aktivitete periodike dhe përmbyllëse

Monitorimi dhe asistenca teknike, nga ana e entit financues, gjatë gjithë implementimit të nismës.

Shërbimet e inxhinierisë të nevojshme për punimet e projektimit të tri segmenteve rrugore do t'i besohen nëpërmjet tenderave, që duhet të kryhen në përputhje me procedurat normative, ashtu siç përshkruhen në paragrafin e mëposhtëm 7.2.

Për tri studimet e fizibilitetit dhe të projektimit përfundimtar, në ekzekutimin e aktiviteteve të studim-analizës, duhet të ndiqet rendi i mëposhtëm:

1. Realizimi dhe/ose marrja e të gjitha informacioneve teknike, kontrolleve, relievet topografike, altometrike, gjeologjike etj., të nevojshme për të grumbulluar të dhëna të sakta dhe informacione të dobishme për hartimin e projektit të infrastrukturës;

2. Hartimin e të paktën dy opsioneve të ndryshme projektesh të nivelit paraprak apo parapërfundimtar, të dobishme për të dhënë zgjidhje alternative për problemet që do të hasen herë pas here;

3. Ekzekutimi i testeve të verifikimit të opsioneve të ndryshme, për dy zgjidhjet e projekteve alternative të propozuara;

4. Hartimi i studimit të fizibilitetit, projektimit nga niveli paraprak në përfundimtar dhe përgatitja e dokumentacionit të garës për tenderin për ekzekutimin e punimeve;

5. Hartimin e Studimit të Impaktit Mjedisor (SIM) të projektit përfundimtar të propozuar, duke e shoqëruar me analizat e mëposhtme:

a) Zënien e terrenit;

b) Plani i parcelave që duhet të shpronësohen;

c) Impakti dhe ndërveprimi me ekosistemin e zonës;



d) Diagramet e zhurmave dhe impakteve përkatës sociale që do të vijnë si pasojë e realizimit të veprave rrugore.

6. Përgatitjen e dokumenteve të tenderit për ekzekutimin e veprave;

Në aktivitetin e projektimit të tri segmenteve rrugore do të merren masat, gjithashtu, për të dhënë një analizë të hollësishme mbi avantazhet në lidhje me realizimin e projektit të infrastrukturës së propozuar, duke dhënë dhe duke propozuar, për secilin segment rrugor, variantin më të mirë nga këndvështrimi teknik dhe ekonomik, në mënyrë koherente me rezultatet e analizave kosto/përfitime.

## BASHKËLIDHJA 2

### KRITERE TË ZGJEDHSHMËRISË, KLAUZOLA ETIKE, PARIME TË PËRGJITHSHME TË KONTRATAVE

#### 1. ZGJEDHSHMËRIA E KONTRAKTUESIT

1.1 Rregullat e objektivitetit dhe të paanshmërisë

Për të shmangur çdolloj konfliktin e interesit, çdo person fizik apo juridik (përfshirë këtu subjekte që i përkasin të njëjtit grup juridik, anëtarë konsorciumi, shoqata të përkohshme dhe nëntenderues) që ka marrë pjesë në përgatitjen e projektit duhet të përjashtohet nga garat e tenderit apo nga përgatitja e ofertave për realizimin e tij.

1.2 Rregullat e kapacitetit ekonomik, financiar, profesional dhe teknik.

Kandidatët/konkurrentët duhet të provojnë që kapacitetet e tyre ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike janë të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të parashikuara nga kontrata. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga Marrëveshja, kandidatët/konkurrentët duhet të provojnë:

1.2.1 Kapacitetin ekonomik dhe financiar: shuma e përgjithshme e faturuar e kandidatëve/konkurrentëve në tri vitet paraardhëse, për të njëjtën kategori objekt tenderi, duhet të jetë të paktën e barasvlershme me shumën maksimale të kontratës; ndërmarrjet që janë krijuar prej më pak se tre vjetësh mund të provojnë kapacitetin e tyre ekonomik dhe financiar me çdolloj dokumenti që porositësi do ta mendojë si të përshtatshëm.

1.2.2 Kapacitetin teknik dhe profesional: kandidatët/konkurrentët duhet të paraqesin një raport të plotë të aktiviteteve të realizuara në tri vitet e mëparshme; ndërmarrjet që janë krijuar prej më pak se tre vjetësh mund të provojnë kapacitetin e tyre teknik dhe profesional me çdolloj dokumenti që porositësi do ta mendojë si të përshtatshëm.

1.3 Shkaqe për përjashtim nga pjesëmarrja në tender

Përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe as nuk mund të shpallen fitues apo të nënshkruajnë kontratat përkatëse, personat fizikë apo juridikë, që:

1.3.1 Ndodhen në një prej situatave të përmendura në dekretin legjislativ italian, datë 08/08/1994, nr. 490 (Antimafia). Kandidatët/konkurrentët italianë duhet të paraqesin “vërtetimin antimafie” të dhënë nga autoritetet italiane kompetente.

1.3.2 Janë në gjendje falimentimi apo likuidimi të detyruar, apo gjenden nën administrim gjyqësor ose në procedurë falimentimi, apo kanë pezulluar aktivitetet e veta, apo ndodhen në një prej situatave të ngjashme në vijim të një procedure të parashikuar nga legjislacioni apo nga rregulloret kombëtare.

1.3.3 U janë nënshtruar procedimeve për deklarimin e falimentimit apo të likuidimit të detyruar, administrimit të kontrolluar, apo procedurave të falimentimit, apo ndodhen në një prej situatave të ngjashme në vijim të një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar.

1.3.4 Ata ose drejtorët e tyre apo partnerët/ortakët e tyre, janë dënuar për një vepër penale në lidhje me sjelljen profesionale, me një vendim të formës së prerë.

1.3.5 Janë fajtorë për sjellje të keqe profesionale të provuar me çdolloj mjeti që porositësi është në gjendje të përdorë.

1.3.6 Nuk kanë përmbushur detyrimet në lidhje me pagesat e sigurimeve shoqërore të parashikuara nga normativa e vendit në të cilin kanë selinë ligjore dhe/ose ku janë ftuar për të punuar.

1.3.7 Nuk kanë përmbushur detyrimet fiskale të parashikuara nga normativa e vendit në të cilin kanë selinë ligjore dhe/ose ku janë ftuar për të punuar.

1.3.8 Janë fajtorë për deklarime të rreme në dhënien e informacioneve të kërkuara nga MPJBN–DPBZH–ja, si kusht për pjesëmarrjen në



një procedurë tenderi apo për shpalljen fitues të një kontrate.

1.3.9 Në periudha të mëparshme kanë zgjidhur kontratën për mospërmbushje, në kuadër të një kontrate tjetër me MPJ-në/DPBZH-në dhe/ose të financuar nga fonde italiane.

## 2. PARIMET E PËRGJITHSHME TË KONTRATAVE

2.1 Besimi dhe ekzekutimi i veprave dhe punëve publike, shërbimeve, furnizimeve, në bazë të këtij kodi, duhet të garantojë cilësinë e shërbimeve dhe të zhvillohet duke respektuar parimet e ekonomisë, të efikasitetit, të respektimit të afateve dhe të korrektësisë; besimi duhet të respektojë gjithashtu parimet e konkurrencës së lirë, barazi trajtimi, jo diskriminim, transparencë, proporcionalitet, si edhe, sa herë të jetë e mundur, atë të reklamës.

2.2 Me marrëveshje paraprake mes palëve, parimi i ekonomisë mund të ndërvarret nga nevojat sociale, si edhe nga mbrojtja e shëndetit dhe e ambientit dhe nga promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

2.3 Procedura e prokurimit të punimeve duhet të anulohet nëse ka më pak se tre kandidatë/ofertues të përshtatshëm.

2.4 Kontratat nuk mund të ndryshohen, pa miratim të hapur të MPJBN–DPBZH-së, dhe sidoqoftë mund të bëhen ndryshime vetëm duke respektuar klauzolat e mëposhtme. Fituesit nuk kanë të drejtë për pagesa apo rimbursime të çdo lloji natyre për aktivitetet e realizuara pa autorizim paraprak. Në rast se MPJBN–DPBZH-ja apo porositësi do ta kërkonin, fituesit duhet të rikthejnë situatën e mëparshme me shpenzimet e veta. Kjo klauzolë është e vlefshme edhe për kontratat e shërbimit.

2.5 Dokumentacioni i tenderit duhet të specifikojë bazën e ankandit për kontratën që do të shpallet fituese.

2.6 Variante të kontratave për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve janë efikase pas autorizimit të shprehur të MPJBN–DPBZH-së, që mund të jepet vetëm në rastet e mëposhtme:

2.6.1 për nevoja që vijnë nga dispozita ligjore dhe rregulluese të mëposhtme;

2.6.2 për rrethana të paparashikuara dhe të paparashikueshme, përfshirë mundësinë e përdorimit të materialeve të reja, përbërësve dhe teknologjive që nuk ekzistojnë në momentin kur kish filluar procedura e tenderit, me kusht që të

përmirësojnë cilësinë e produktit apo të shërbimit, pa rritur për këtë arsye shumën e përgjithshme kontraktuale;

2.6.3 Për verifikimin e ngjarjeve të lidhura me natyrën apo me cilësinë e mallrave apo të vendeve në të cilat po ndërhyhet, gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk ishin të parashikueshme në momentin e nënshkrimit të vetë kontratës;

2.6.4 Nëse nuk përcaktohet ndryshe, ndryshimet e lartpërmendura nuk mund të rrisin apo të ulin për më shumë se 20% shumën totale të kontratës;

2.6.5 Gjithashtu, pranohen ndryshime që, në interesin ekskluziv të porositësit, përcaktojnë një rritje apo një ulje të shërbimeve të fituesit deri në maksimumin e 5% të shumës totale të kontratës, me kusht që të synojnë përmirësimin apo funksionimin më të mirë të shërbimeve objekt i kontratës, të mos sjellin ndryshime thelbësore dhe burimet financiare shtesë të jenë të disponueshme; këto ndryshime mund të motivohen vetëm nga objektiva dhe nevoja që vijnë nga rrethana të papritura dhe të paparashikueshme për momentin e nënshkrimit të kontratës.

2.6.6 Fituesit janë të detyruar t'u nënshtrohen varianteve, si më sipër, me të njëjtat kushte të kontratës;

2.6.7 Në çdo rast, fituesit kanë detyrimin të kryejnë të gjitha ato variante me karakter jo-thelbësor që mendohen si të nevojshme nga porositësi, me kusht që të mos ndryshojnë thelbësisht natyrën e aktivitetit objekt të kontratës dhe të mos sjellin detyrime më të mëdha.

2.7 Variante të kontratës së punimeve janë efikase vetëm pas autorizimit të shprehur të MPJ-së/DPBZH-së, që mund të jepet vetëm në rastet e mëposhtme:

2.7.1 për nevoja që vijnë nga dispozita ligjore dhe rregulluese të mëposhtme;

2.7.2 për shkaqe të paparashikuara dhe të paparashikueshme apo për mundësinë e përdorimit të materialeve, përbërësve dhe teknologjive që nuk ekzistojnë në momentin e projektimit që mund të përcaktojnë, pa rritje kostoje, përmirësime të ndjeshme në cilësinë e veprës apo të pjesëve të saj dhe gjithmonë që të mos ndryshojnë strukturën e projektit original.

2.7.3 për ngjarjet e verifikuara gjatë punimeve në lidhje me natyrën dhe me specifikën e mallrave të cilat ndërhyhet apo për konstatime të papritura



apo të paparashikueshme në fazën e projektit;

2.7.4 probleme gjeologjike të paparashikueshme në projektin ekzekutiv;

2.7.5 për shfaqjen e gabimeve apo të mungesave të projektit ekzekutiv që dëmtojnë, pjesërisht apo totalisht, realizimin e veprës apo përdorimin e saj; në këtë rast, të ngarkuarit me projektimin janë të përgjegjshëm për dëmet e pësuar nga entet tenderuese; fituesit e garës nuk mund të refuzojnë të kryejnë këto ndryshime me kusht që kostoja e tyre të mos i kalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës;

2.7.6 ndryshime që, në interes të porositësit, përcaktojnë një rritje apo një pakësim të shërbimeve të fituesit deri në një maksimum prej 5% të shumës totale të kontratës, dhe që janë të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e veprave/punimeve, do të pranohen me kusht që të jenë të disponueshme burimet financiare shtesë.

2.8 Kontratat nuk mund t'u jepen të tretëve, ndryshe rëndon si penaltet zgjidhja me të drejtë e kontratave të shpallura fituese më parë.

2.9 Nuk lejohet nëntenderimi, me përjashtim për aktivitetet në lidhje me relievet topografike, matjet dhe/ose perimetrimet, përgatitjet e projekteve specialistike dhe të detajeve, sidoqoftë deri në një maksimum prej 30% të vlerës totale të kontratës. Sidoqoftë konkurruesit duhet të deklarojnë, në ofertat e tyre, se cilat furnizime/shërbime, kanë ndër mend të nëntenderojnë. Në rast nëntenderimi, fituesit duhet të depozitojnë kontratat përkatëse pranë entit tenderues dhe një kopje pranë zyrave të Bashkëpunimit Italian në Tiranë, me mënyrat dhe afatet e paraqitura në shpalljen e tenderit. Nëntenderuesit duhet të kenë karakteristikat për të marrë pjesë për furnizimet/shërbimet që duhet të realizojnë.

2.10 Çmimet e kontratës janë fikse dhe jo subjekt rishikimi.

2.11 Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen ekskluzivisht në euro. Rreziqet dhe ndryshimet e përqindjes së këmbimit nuk i nënshtrohen asnjë kompensimi.

2.12 Kontrata zgjidhet me të drejtë, në rast se fituesit u nënshtrohen procedurave të falimentimit apo të likuidimit të detyruar, administrimit gjyqësor apo procedurës falimentuese paraprake, apo ndodhen në një prej situatave të ngjashme në vijim të një procedure të parashikuar nga legjislacioni përkatës kombëtar.

2.13 Nuk pranohet asnjë kufizim përgjegjësie i fituesit të tenderit kur kemi të bëjmë me dashje apo me pakujdesi të rëndë.

2.14 Zbatimi i kontratës rregullohet nga ligji i vendit përfitues.

2.15 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet fituesit të shpallur dhe entit tenderues nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

2.16 Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e sipërpërmendura.

2.17 Në rast vakumi në legjislacion, pala italiane rezervon të drejtën të aplikojë parimet themelore të legjislacionit italian.

2.18 Mundësia për të aksesuar aktet do të rregullohet sipas mënyrave të mëposhtme:

1. Me përjashtim të disiplinës së parashikuar për tenderat që i nënshtrohen sekretit apo ekzekutimi i të cilëve kërkon masa të veçanta sigurie, e drejta për të aksesuar aktet shtyhet në kohë:

a) Në procedurat e hapura, në lidhje me listën e subjekteve që kanë paraqitur ofertat, deri në skadimin e afatit për paraqitjen e tyre;

b) Në procedurat e kufizuara dhe në ato me negociata, dhe në çdo rast tenderi informal, në lidhje me listën e subjekteve që kanë bërë kërkesë për t'u ftuar apo që kanë shfaqur interesin e tyre, me listën e subjekteve që janë ftuar për të paraqitur ofertat dhe me listën e subjekteve që kanë paraqitur oferta, deri në skadimin e afatit të paraqitjes së vetë ofertave; subjekteve që u është refuzuar kërkesa për t'u ftuar, u lejohet futja në listën e subjekteve që kanë bërë kërkesë për t'u ftuar apo që kanë shfaqur interesin e tyre, pas komunikimit zyrtar, nga ana e enteve tenderues, të emrave të kandidatëve për t'u ftuar;

c) Në lidhje me ofertat deri në aprovimin e shpalljes së fituesit;

c-bis) në lidhje me procedimet e kontrollit të anomalisë së ofertës deri në shpalljen përfundimtare të fituesit.

(Germa e shtuar nga neni 2), pika 1, germa “e”, “d” e ligjit nr. 152 datë 2008.)

2. Aktet për të cilat flitet në pikën 1, deri në afatet e parashikuara atje, nuk mund t'u komunikohen të tretëve apo të bëhen të ditura në ndonjë mënyrë.

3. Mosrespektimi i pikës 1 dhe i pikës 2, për nëpunësit shtetërorë apo për të ngarkuarit e shërbimeve publike, sjell si pasojë aplikimin e nenit 326 të Kodit Penal.



4. Me përjashtim të disiplinës së parashikuar për tenderat që i nënshtrohen sekretit apo ekzekutimi i të cilëve kërkon masa të veçanta sigurie, përjashtohen e drejta e hyrjes dhe çdo formë tjetër përhapje në lidhje:

a) Me informacionet e dhëna nga ofertuesit në kuadër të ofertave apo të përligjjes së tyre, që përbëjnë, sipas deklaratës së arsyetuar dhe të provuar të ofertuesit, sekrete teknike apo tregtare;

b) Me aspekte të tjera të mundshme me karakter të rezervuar të ofertave, për t'u individualizuar në rregullore;

c) Me mendimet ligjore të marra nga subjektet që duhet të respektojnë aplikimin e këtij kod, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme apo në akte, në lidhje me kontratat publike;

d) Me relacionet e rezervuara nga drejtori i punimeve dhe nga organi i kolaudimit për kërkesat dhe për rezervat e subjektit ekzekutues të kontratës.

5. Në lidhje me hipotezën për të cilën është folur në pikën 4, germa “a” dhe “b”, sidoqoftë konkurenti që e kërkon lejohet të hyjë në aktet e procedurës në rast se i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e interesave të veta në lidhje me procedurën e besimit të kontratës në kuadër të së cilës formulohet kërkesa për të aksesuar aktet.

6. Vetëm për kontratat e sektorëve të veçantë që i nënshtrohen disiplinës së pjesës III të d. lgj. nr. 163/2006, në momentin e përcjelljes së specifikimeve teknike operatorëve ekonomikë të interesuar, kualifikimit dhe të seleksionimit të operatorëve ekonomikë dhe në momentin e besimit të kontratave, entet që shpallin fituesin mund të imponojnë kushte për të ruajtur karakterin e rezervuar të informacioneve që transmetojnë.

6-bis) Entet që shpallin fituesit u vënë në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar dhe që bëjnë kërkesë, detajet teknike rregullisht të parashikuara në tenderat e tyre për furnizime, për punime dhe për shërbime apo specifikimet teknike të cilave kanë nder mend t'u referohen për tenderat që janë objekt njoftimesh periodike treguese. Kur specifikimet teknike bazohen në dokumente që mund të shihen nga operatorët ekonomikë të interesuar, konsiderohet e mjaftueshme paraqitja e referimit për këto dokumente.

### 3. KOSTO TË PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME

3.1 Kostot e paraqitura në kontratat janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe

të nevojshme për realizimin e projektit sipas dokumentit të projektit.

3.2 Sidoqoftë, kostot në lidhje me mallrat/shërbimet e mëposhtme nuk konsiderohen të pranueshme:

a) Shpenzime qejfi apo luksi (p.sh., parfumet, produktet kozmetike, veprat e artit, pijet alkoolike, artikujt sportivë etj.);

b) Mallra apo shërbime të lidhura direkt apo indirekt me aktivitete ushtarake dhe policie;

c) Të gjitha taksat dhe tatimet indirekte (përfshirë TVSH-në) dhe të drejtat doganore;

d) Amortizimet e huave të marra më parë dhe humbjeve të mëpasshme të përfituesit apo të përdoruesve finalë;

e) Interesat ndaj të tretëve nga ana e përfituesit apo e përdoruesve finalë.

### 4. KLAUZOLA ETIKE

4.1 Çdolloj tentative nga ana e konkurrentëve (të mundshëm apo jo), për të marrë informacione konfidenciale, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentë të tjerë apo për të influencuar entin tenderues në fazat e analizës, të krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, do të shpjerë në përjashtimin nga gara të konkurrentit/tëve, dhe me eliminimin e ofertës së tij/tyre, përveç aplikimit të sanksioneve administrative.

4.2 Fituesit dhe personeli i tyre apo çdolloj shoqërie/ndërmarrje tjetër me të cilën fituesi është i asocuar apo lidhet, nuk do të mundin të realizojnë shërbime apo të furnizojnë mallra në kuadër të kontratës, as në formë plotësuese apo nëntenderimi, pa autorizimin paraprak me shkrim të autoritetit tenderues. Kjo ndalesë aplikohet edhe në çdolloj tjetër projekti që, për shkak të natyrës së kontratës, mund t'i hapë rrugë një konflikti interesi të fituesit.

4.3 Në paraqitjen e ofertës së vet në një garë, konkurrentët duhet të deklarojnë se nuk kanë asnjë konflikt të mundshëm interesash dhe se nuk kanë asnjë lidhje specifike me konkurrentë të tjerë apo me palë të tjera të përfshirë në projekt në çdolloj cilësie. Në rast se do të dilte në pah një situatë e tillë gjatë ekzekutimit të kontratës, fituesit duhet të informojnë menjëherë entin tenderues.

4.4 Funksionarët shtetërore apo personeli tjetër që punon në administratën publike të vendit përfitues, pavarësisht nga pozicioni specifik administrativ në të cilin gjenden, nuk mund të punësohen si ekspertë/konsulentë nga shoqëritë/



ndërmarrjet pjesëmarrëse në garë pa miratimin paraprak të MPJBN–DPBZH-së.

4.5 Fituesit duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje me kodin e sjelljes së profesioneve përkatëse. Ata nuk mund të bëjnë deklarime publike për projektin apo për shërbimet që u janë kërkuar atyre, pa miratimin paraprak të entit tenderues. Ata (sidoqoftë) nuk mund të angazhojnë në asnjë mënyrë entin tenderues pa pëlqimin e tij paraprak me shkrim.

4.6 Për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit dhe personeli i tyre duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe të impenjohen të mos cenojnë parimet, traditat dhe zakonet politike, kulturore dhe fetare të vendit përfitues. Në veçanti fituesit e kontratave duhet të respektojnë standardet themelore të punës siç janë përcaktuar në konventat kryesore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës – ONP (si “Konventa për lirinë sindikaliste dhe mbrojtjen e të drejtës sindikaliste”, “Konventa për të drejtën e organizimit dhe të negocimit kolektiv”, “Konventa për punën e detyruar”, “Konventa për diskriminimin (detyra dhe profesioni)”, dhe “Konventa për format më të këqija të punës së të miturve”).

4.7 Fituesit nuk mund të pranojnë pagesa të lidhura me kontratën, të ndryshme nga ato që janë parashikuar në të. Fituesit dhe personeli i tyre nuk duhet të ushtrojnë asnjë aktivitet apo të kenë ndonjë avantazh nga ana e entit tenderues, që nuk janë koherentë me detyrimet përkatëse kontraktuale.

4.8 Është e detyrueshme për fituesit dhe për personelin e tyre të ruajnë sekretin profesional gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe edhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara apo të marra nga fituesi janë konfidenciale.

4.9 Kontrata duhet të rregullojë përdorimin, nga ana e të gjithë kontraktuesve, e raporteve dhe të dokumenteve të hartuar, të marrë apo të paraqitur nga ata vetë, gjatë ekzekutimit të saj.

4.10 Fituesit duhet të shmangin çdo lloj raporti/marrëdhënie që mund të kompromentojë/dëmtojë pavarësinë e tyre apo atë të personelit të vet. Në rast se fituesit nuk do të ishin më të pavarur, autoriteti porosites, me përjashtim të pagesës së dëmeve, mund të zgjidhë kontratën pa paralajmërim dhe pa i dhënë mundësi fituesit të paraqesë pretendimet për dëmshpërblim.

4.11 MPJBN–DPBZH-ja rezervon të drejtën të pezullojë apo të anulojë financimin e projektit, në rast se do të dalin në pah praktika korrupsioni të çdo lloji në çdo lloj stadi të procedimit të shpalljes së fituesit dhe në rast se autoriteti porosites nuk ishte në gjendje të marrë të gjithë masat e duhura për të rregulluar gjendjen që është krijuar. Për efektet e kësaj klauzole, me “praktika korruptive” nënkuptohen ofertat e rryshfetit, dhurata, dhurime apo përqindje, të nënkuptuara si stimuj apo shpërblime për këdo që ka kryer apo nuk ka kryer, çdo lloj akti në lidhje me besimin apo me realizimin e një kontrate të përfunduar tashmë me autoritetin porosites.

4.12 Më saktësisht, gjithë dokumentacioni i garës dhe kontratat përkatëse për vepra, furnizime dhe shërbime, duhet të përfshijnë një klauzolë që parashikon anulimin e garës së tenderit apo zgjidhjen e kontratës në rast se do të dilte në pah që dhënia e kontratës apo ekzekutimi i saj kanë shkaktuar shpenzime tregtare të pazakonta. “Shpenzimet tregtare të pazakonta” janë komisione që nuk janë përmendur në kontratën kryesore apo që nuk vijnë nga një kontratë e përfunduar korrektesash dhe që i referohet kontratës kryesore, komisione që nuk janë paguar në vijim të shërbimeve të ligjshme dhe realisht të dhëna, komisione të paguara në një parajsë fiskale, komisione që i janë paguar një përfituesi të paidentifikuar qartësisht apo komisione që i janë paguar një shoqërie që duket se kërkon të mbulojë një tjetër.

4.13 Në rast se do t’u kërkohej nga ana e MPJBN–DPBZH-së, fituesit angazhohen të japin elemente prove për të shpjeguar kushtet në të cilat realizohet kontrata. MPJBN–DPBZH-ja mund të kryejë çdo lloj kontrolli, të dokumentacionit apo në vend, që do ta mendojë si të domosdoshëm për të grumbulluar elemente prove në rastet e shpenzimeve tregtare të dyshimta të pazakonta.

4.14 Në bazë të rëndësës së fakteve të konstatuara, fituesit që kanë paguar shpenzime tregtare të pazakonta në projekte të financuara nga MPJBN–DPBZH-ja do t’i nënshtrohen zgjidhjes së kontratës apo përjashtimit të përhershëm për të marrë pagesa me financim nga MPJBN–DPBZH-ja.

4.15 Mosrespektimi i njëres apo më shumë klauzolave etike mund të përcaktojë përjashtimin e konkurrentit apo fituesit nga kontrata të tjera të



financuara – pjesërisht apo totalisht – nga MPJBN–DPBZH-ja, dhe aplikimin e penaliteteve. Individit apo ndërmarrja që konsiderohet si përgjegjës/e duhet të informohet me shkrim për faktin.

4.16 Është e detyrueshme për entin tenderues të sigurojë që procedurat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve të përcaktohen në mënyrë transparente, të bazuar në kritere objektive dhe në mënyrë të pavarur nga çdo lloj influence e jashtme.

BASHKËLIDHJA 3

PLANI FINANCIAR

Ref.	Gara	K. e Butë e vlerësuar	K. e Butë efektive (ulje të mundshme ankandi)	Livrimi i transheve	Kontraktori	Shpenzime lokale %
1	<b>BY PASS ELBASAN</b>	<b>350.000,00</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- 20% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, e raportit për fillimin e projektimit;</li> <li>- 30% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektit paraprak;</li> <li>- 30% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektit përfundimtar dhe të planit grafik dhe përshkrues të shpronësimeve;</li> <li>- 20% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektimit të plotësuar me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së tenderit, si dhe të dokumenteve të tenderit për realizimin e veprave të projektuara.</li> </ul>		
2	<b>MILOT-SHKODËR</b>	<b>750.000,00</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- 20% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, e raportit për fillimin e projektimit;</li> <li>- 30% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektit paraprak;</li> <li>- 30% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektit përfundimtar dhe të planit grafik dhe përshkrues të shpronësimeve;</li> <li>- 20% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektimit të plotësuar me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së tenderit, si dhe të dokumenteve të tenderit për realizimin e veprave të projektuara.</li> </ul>		
3	<b>VAQARR-KAVAJË</b>	<b>850.000,00</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- 20% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, e raportit për fillimin e projektimit;</li> <li>- 30% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektit paraprak;</li> <li>- 30% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të projektit përfundimtar dhe të planit grafik dhe përshkrues të shpronësimeve;</li> <li>- 20% të shumës së kontratës, me miratimin, nga ana e MTI-së, të</li> </ul>		



				projektimit të plotësuar me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së tenderit, si dhe të dokumenteve të tenderit për realizimin e veprave të projektuara.		
4a	<b>NJËSIA TEKNIKE MTI</b>	<b>108.000,00</b>		Sipas kohëzgjatjes së detyrave të personelit të huaj që do të punojë në Shqipëri		
4b	<b>NJËSIA TEKNIKE MTI</b>	<b>42.000,00</b>		Sipas kohëzgjatjes së detyrave të personelit vendas		
<b>TOTALI I KREDISË SË NDIHMËS</b>		<b>2.100.000,00</b>		<b>TOTALI I SHPENZIMEVE VENDASE NË NGARKIM TË QEVERISË SHQIPTARE</b>		<b>420.000,00</b>

#### BASHKËLIDHJA 4

#### MËNYRAT E EKZEKUTIMIT DHE TË ADMINISTRIMIT TË KREDISË SË BUTË

#### SEKSIONI 1 – SHPALLJA E NJOFTIMIT PËR TENDER, PROCEDURA E ZBATIMIT

Dokumentacioni duhet të përgatitet në përputhje me sa është përshkruar në Manualin e procedurave (PRAG i miratuar nga Komisioni Evropian – versioni i marsit 2011 me anekset përkatëse në lidhje me dokumentet e tenderit për shërbimet dhe furnizimet) dhe me ndryshimet e mundshme të mëpasshme, me përjashtim të pjesës që lidhet me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën, e cila do t'u përshtatet specifikave të kredisë së ndihmës italiane në lidhje me tenderin për shërbimet, në kuadrin e Bashkëpunimit të Komunitetit Evropian me vendet e treta, si edhe asaj që është saktësuar në bashkëlidhjen nr. 2. Sidoqoftë, dokumentacioni duhet:

- Të specifikojë “kushtet e veçanta” në lidhje me secilin tender;

- Të qartësojë kriteret vlerësuese që do të zbatohen nga komisioni i ngritur nga MTI-ja.

##### Metodologjia

##### 1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

MTI-ja do të përgatisë dokumentacionin e garës për seleksionimin e shoqërive të cilave do t'u besohen punimet (shërbime inxhinierie). Ky dokumentacioni garë, i kontrolluar dhe/ose plotësuar nga Njësia Teknike Lokale e Tiranës, do t'i dërgohet pastaj zyrtarisht Ambasadës/njesisë teknike lokale nga MTI-ja, së bashku me kërkesën për publikimin e shpalljes së garës në shtypin e përditshëm italian.

2. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni i tenderit, i kontrolluar dhe/ose plotësuar, do t'i dërgohet Ambasadës/njesisë teknike lokale nga MTI-ja, së bashku me kërkesën për publikimin e shpalljes së tenderit në shtypin e përditshëm italian, për verifikimin e përputhshmërisë me këtë Marrëveshje. Kontrolli përfundimtar do të bëhet nën kujdesin e MPJBN-DPBZH-së dhe ka të bëjë, në veçanti, me përputhshmërinë:

- e procedurës së tenderit me planin financiar të miratuar nga palët;

- e përmbajtjeve me karakter ligjor me procedurat e paraqitura në bashkëlidhjen 2;

- e specifikimeve teknike dhe të parametrave vlerësues me objektivat që Programi synon të arrijë.

##### 3. Publikimi i dosjes së tenderit

Në rast se merret mendimi pozitiv dosjet e tenderave do të publikohen, nga ana e MPJBN-DPBZH-së, në shtypin kryesor të përditshëm italian dhe në faqen e internetit të MPJBN-së. Në të njëjtën kohë MTI-ja do të procedojë me publikimin e dosjes së tenderave në shtypin kombëtar shqiptar.

#### SEKSIONI II - FAZAT E SHPALLJES SË FITUESIT – PROCEDURA E APLIKUAR

Zhvillimi i tenderave dhe kontrolli i përputhshmërisë së kriterëve të përdorura nga komisioni vlerësues:

- MTI-ja do të ngrejë një njësi teknike të përbërë nga personel të kualifikuar vendas dhe italian, që do të ketë funksionet e përfaqësueses së entit tenderues.

- Njësia teknike do të udhëzojë dokumentacionin e nevojshëm për shpalljen e tenderave respektivë. Ky dokumentacion duhet të paraqitet në përputhje me Manualin e procedurave (PRAG i





miratuar nga Komisioni Evropian – versioni i fundit) dhe bashkëlidhjet përkatëse, përveç pjesës që ka të bëjë me rregullat mbi kombësinë dhe origjinën, e cila do të adaptohet sipas specifikimeve të kredisë së ndihmës italiane, si dhe nga sa specifikohet në bashkëlidhjen 2.

- Shuma e nevojshme për njësinë teknike dhe personelin e saj vendas dhe italian prej 150,000.00 eurosh, do të gjendet në kuadër të kredisë së butë (shiko nenin 9 dhe bashkëlidhjen 3, pika 4/b).

- Shuma e nevojshme për Asistencën Teknike Italiane do të gjendet në kuadër të kredisë së butë (shiko nenin 9 dhe bashkëlidhjen 3, pika 4) deri në një shumë prej 108,000.00 eurosh.

- MTI-ja, nëpërmjet njësisë teknike, e ngarkuar për monitorimin e projekteve që do të përfitojnë nga financimet ndërkombëtare, do të ndjekë ecurinë e tenderave, duke asistuar edhe komisionin vlerësues të ofertave (të caktuar nga MTI-ja).

- Pasi të ketë përfunduar vlerësimi, përpara shpalljes formale të fituesit, MTI-ja do t'i kërkojë DPBZH-së verifikimin e përputhshmërisë së tenderit.

#### Metodologjia

1. Shqyrtimi i ofertave që mbërrijnë për çdo tender do të bëhet nga një Komision Vlerësimi i ngritur posaçërisht nga MTI-ja. Në hapjen e ofertave dhe, sidoqoftë, në të gjitha mbledhjet publike të komisionit vlerësues, mund të marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit, një përfaqësues i ngarkuar i Ambasadës/njësisë teknike lokale.

2. Për secilin tender, MTI-ja do t'i transmetojë Ambasadës/njësisë teknike lokale dokumentacionin me aktet e komisionit, së bashku me kontratën për t'u lidhur dhe me kërkesën për lejen për nënshkrimin e kontratës. Ky dokumentacion do t'i transmetohet MPJBN-DPBZH-së nga Ambasada/njësia teknike lokale, me komentet e mundshme.

3. MPJBN-DPBZH-ja do të verifikojë kryesisht përputhshmërinë ligjore dhe teknike të vlerësimeve të bëra me procedurat dhe kriteret/parametrat e parashikuara në kushtet e tenderit.

4. Pasi të kenë përfunduar verifikimet, MPJ-DPBZH-ja do të informojë Ambasadën/njësinë teknike lokale për përfundimin e tyre.

5. Ambasada/njësia teknike lokale do t'i komunikojë MTI-së përfundimin e verifikimeve që ka bërë MPJBN-DPBZH-ja.

6.

7. Në rast përfundimi pozitiv (leje), MTI-ja do të procedojë me lidhjen e kontratës me shoqëritë që kanë rezultuar fituese.

#### SEKSIONI III – FAZA TË MBËSHTETJES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMET PROCEDURA E APLIKUAR

1. Kontratat e formalizuara ndërmjet shoqërisë së shpallur fituese dhe MTI-së duhet t'i dërgohen MPJBN-DPBZH-së me ndërmjetësinë e Ambasadës/njësisë teknike lokale, së bashku me një deklaratë angazhimi nga ana e Palës shqiptare për të përballuar shpenzimet lokale në lidhje me taksën mbi vlerën e shtuar, taksat doganore, shpronësimet etj.

2. Pasi të jetë bërë verifikimi i përputhshmërisë së kontratës me dokumentet e tenderit, MPJBN-DPBZH-ja do t'i dërgojë Administratorit të kredisë lejen për mbështetjen e kontratës bazuar në Marrëveshjen Financiare.

3. Sapo të jetë marrë leja e lartpërmendur në pikën 2, Administratori i kredisë do të plotësojë praktikën, duke i kërkuar fituesit që mallrat e mundshme që duhen blerë për qëllimet e shërbimeve profesionale dhe/ose shërbimeve dytësore, të jenë me prejardhje italiane. Pas rezultatit pozitiv të kësaj praktike dhe me marrjen e kërkesës për financim nga ana e Huamarrësit, Artigiancassa do t'i komunikojë huamarrësit, dhe MPJBN-DPBZH-së futjen dhe financimin e kontratës bazuar në Marrëveshjen financiare.

4. Siç është përcaktuar në kontratë, Administratori i kredisë do t'i hapë rrugë pagesës së paradhënieve, pasi të ketë marrë kërkesën për livrimin me anë të dokumentacionit administrativ të parashikuar bashkëngjitur (fatura tregtare, *packing list*, *bill of lading* etj.) dhe pasi të ketë verifikuar përputhshmërinë e vetë dokumentacionit me kontratën e autorizuar. Kërkesa për livrimin do t'i dërgohet me kopje Huamarrësit. Pagesat mund të vendosen vetëm pas autorizimit për të proceduar nga ana e Huamarrësit: sidoqoftë ky autorizim duhet të vijë brenda 30 ditësh duke filluar nga data e secilës kërkesë për livrim.



**LIGJ**  
**Nr. 87/2016**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË NË KONVENTËN**  
**EVROPIANE TË PEIZAZHEVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Evropiane të Peizazheve, bërë në Firence, më 20 tetor 2000.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.9.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9747, datë 16.9.2016,**  
**të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bujar Nishani**

*Seria e Traktateve Evropiane - nr. 176*

**KONVENTA EVROPIANE**  
**E PEIZAZHEVE**

Firence, 20.X.2000

**Hyrje**

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të kësaj Konvente,

*duke pasur parasysh se* qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij, me qëllim që të ruajë dhe të realizojë idealet dhe parimet që janë trashëgimi e tyre e përbashkët, dhe se ky qëllim është ndjekur në veçanti nëpërmjet marrëveshjeve në fushat ekonomike e shoqërore;

*të interesuar për të* arritur një zhvillim të qëndrueshëm të mbështetur në një marrëdhënie të balancuar dhe harmonike midis nevojave shoqërore, veprimtarisë ekonomike dhe mjedisit;

*duke vërejtur se* peizazhi ka një rol të rëndësishëm me interes publik në fushat kulturore, ekologjike,

mjedisore e shoqërore, dhe përbën një burim të favorshëm për veprimtarinë ekonomike, mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i të cilit mund të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës;

*të ndërgjegjshëm se* peizazhi ndihmon në formimin e kulturave vendore dhe se është komponent bazë i trashëgimisë natyrore e kulturore të Evropës, duke kontribuar në mirëqenien e njerëzve dhe konsolidimin e identitetit evropian;

*duke pranuar se* peizazhi është pjesë e rëndësishme e cilësisë së jetës për njerëzit kudo: në zonat urbane e në fshatra, në zonat e degraduara, si dhe në zonat me cilësi të lartë, në zonat që njihen se kanë bukuri të veçantë, si dhe në zonat e zakonshme;

*duke vërejtur se* zhvillimet në teknikat e prodhimit bujqësor, pyjor, industrial e mineral dhe në planifikimin rajonal, urbanistikë, transport, infrastrukturë, turizëm e argëtim dhe në nivel më të përgjithshëm, ndryshimet në ekonominë botërore, në shumë raste, po përshpejtojnë transformimin e peizazheve;

*duke dëshiruar t'i* përgjigjen dëshirës së publikut për të gëzuar peizazhe cilësore dhe për të luajtur një rol aktiv në zhvillimin e peizazheve;

*të bindur se* peizazhi përbën një element kyç për mirëqenien individuale e shoqërore, dhe se mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i tij sjellin të drejta e përgjegjësi për secilin;

*duke pasur parasysh* tekstet juridike ekzistuese në nivel ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe administrimit të trashëgimisë natyrore e kulturore, planifikimit rajonal dhe hapësinor, bashkëpunimin mes vetëqeverisjes vendore dhe atë ndërkufitar, në veçanti Konventën për Ruajtjen e Kafshëve dhe Bimëve dhe Habiteteve Natyrore të Evropës (Bernë, 19 shtator 1979), Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturore të Evropës (Granada, 3 tetor 1985), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike (të rishikuar) (La Valeta, 16 janar 1992), Konventën Kuadër Evropiane për Bashkëpunimin Ndërkufitar të Komuniteteve apo Autoriteteve Territoriale (Madrid, 21 maj 1980), si dhe protokollin e saj shtesë, Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore (Strasburg, 15 tetor 1985), Konventën për Diversitetin Biologjik (Rio, 5 qershor 1992), Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore (Paris, 16 nëntor 1972), si dhe Konventën për Aksesin në



Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (Aarhus, 25 qershor 1998);

*duke pranuar se* cilësia dhe larmia e peizazheve evropiane përbën një burim të përbashkët, dhe se është e rëndësishme të bashkëpunohet për mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e tij;

*duke dëshiruar* të krijojnë një instrument të ri kushtuar tërësisht mbrojtjes, menaxhimit dhe planifikimit të të gjitha peizazheve në Evropë, kanë rënë dakord si më poshtë:

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Peizazh” do të thotë një zonë, siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilit është rrjedhojë e veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/apo njerëzorë;

b) “Politikë peizazhi” do të thotë shprehja nga autoritetet publike kompetente e parimeve të përgjithshme, strategjive dhe udhëzimeve që lejojnë marrjen e masave të veçanta, të cilat synojnë mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazheve;

c) “Objektiv i cilësisë së peizazhit”, për një peizazh specifik, do të thotë formulimi nga autoritetet publike kompetente, i aspiratave të publikut në lidhje me tiparet e peizazhit të mjedisve të tyre;

d) “Mbrojtje e peizazheve” do të thotë veprime për të ruajtur dhe mirëmbajtur tiparet e rëndësishme apo karakteristike të një peizazhi, të përligjura nga vlera e tij trashëgimore, që rrjedh nga konfigurimi i tij natyror dhe/apo veprimtaria njerëzore;

e) “Menaxhim i peizazheve” do të thotë veprim nga perspektiva e zhvillimit të qëndrueshëm, për të siguruar mirëmbajtjen e rregullt të peizazhit për të udhëzuar dhe harmonizuar ndryshimet që sjellin proceset shoqërore, ekonomike dhe mjedisore;

f) “Planifikim i peizazheve” do të thotë veprim i fuqishëm reformues për të përmirësuar, restauruar apo krijuar peizazhe.

### Neni 2 Objekti

Në bazë të dispozitave të nenit 15, kjo Konventë është e vlefshme në të gjithë territorin e Palëve dhe mbulon zonat natyrore, rurale, urbane dhe peri-urbane. Ajo përfshin zonat tokësore, ujërat e brendshme dhe detare. Objekti i Konventës përfshin peizazhet që mund të konsiderohen të veçanta, si dhe me peizazhet e mjedisit të përditshëm dhe peizazhet e degraduara.

### Neni 3 Qëllimet

Qëllimet e kësaj Konvente janë që të nxisë mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazhit, dhe të organizojë bashkëpunimin evropian për çështjet e peizazhit.

## KREU II MASAT KOMBËTARE

### Neni 4 Ndarja e përgjegjësi

Secila Palë do të zbatojë këtë Konventë, veçanërisht nenet 5 dhe 6, sipas ndarjes së kompetencave të saj, në përputhje me parimet e saj kushtetuese dhe organizimin administrativ, si dhe duke respektuar parimin e subsidiaritit në bazë të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Pa deroguar nga dispozitat e kësaj Konvente, secila Palë do të harmonizojë zbatimin e kësaj Konvente me politikat e saj.

### Neni 5 Masa të përgjithshme

Çdo Palë merr përsipër:

a) të njohë ligjërisht peizazhin si një komponent thelbësor i mjedisve të njerëzve, shprehje të larmisë së trashëgimisë së tyre të përbashkët kulturore e natyrore, dhe si themel të identitetit të tyre;

b) të përcaktojë dhe të zbatojë politika për peizazhet që synojnë mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazhit nëpërmjet marrjes së masave të veçanta të parashikuara nga neni 6;

c) të krijojë procedura për pjesëmarrjen e publikut të gjerë, të autoriteteve vendore e rajonale, dhe të palëve tjera të interesuara për përcaktimin dhe realizimin e politikave të peizazhit të përmendura në paragrafin “b” më sipër;



d) të përfshijë peizazhin në politikat e saj rajonale dhe të urbanistikës dhe në politikat e saj kulturore, mjedisore, bujqësore, shoqërore dhe ekonomike, si dhe në çdo politikë tjetër me ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi peizazhin.

Neni 6

### Masa të veçanta

#### A. Rritja e ndërgjegjësimit

Çdo Palë merr përsipër të rrisë ndërgjegjësimin e shoqërisë civile, organizatave private dhe autoriteteve publike për vlerën e peizazheve, rolin dhe ndryshimin e tyre.

#### B. Trajnimi dhe arsimimi

Çdo Palë merr përsipër të nxisë:

a) trajnimin e specialistëve për vlerësimin e peizazheve dhe operacionet në lidhje me to;

b) programet trajnuese shumëdisiplinore në lidhje me politikën, mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazhit, për profesionistë të sektorit privat e publik dhe për shoqatat e interesuara;

c) kurse shkollore dhe universitare të cilat, në lëndët përkatëse, të trajtojnë vlerat që lidhen me peizazhet dhe çështjet që rrjedhin nga mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i tyre;

#### C. Identifikimi dhe Vlerësimi

1. Me pjesëmarrjen aktive të Palëve të interesuara, siç parashikohet në nenin 5/c, dhe duke synuar një njohje më të mirë të peizazheve të saj, secila Palë merr përsipër:

a) të identifikojë peizazhet e veta në të gjithë territorin e saj;

ii) të analizojë karakteristikat e tyre dhe forcat e presionet që ndikojnë në transformimin e tyre;

iii) të ndjekë ndryshimet e tyre;

b) të vlerësojë peizazhet e identifikuar në këtë mënyrë, duke marrë parasysh vlerat e veçanta që u jepen nga palët dhe popullata e interesuar.

2. Këto procedura identifikuese dhe vlerësuese udhëhiqen nga shkëmbimet e përvojës dhe metodologjisë, të organizuara ndërmjet Palëve në nivel evropian, sipas nenit 8.

#### D. Objektiva për cilësinë e peizazheve

Çdo Palë merr përsipër të përcaktojë objektiva për cilësinë e peizazheve të identifikuar dhe të vlerësuar pas konsultimeve me publikun, në përputhje me nenin 5/c.

#### E. Zbatimi

Për zbatimin e politikave të peizazhit, çdo Palë

merr përsipër të prezantojë instrumente që synojnë mbrojtjen, menaxhimin dhe/apo planifikimin e peizazheve.

KREU III

### BASHKËPUNIMI EVROPIAN

Neni 7

### Politikat dhe programet ndërkombëtare

Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë për të konsideruar çështjen e peizazhit në politikat dhe programet ndërkombëtare, dhe për të rekomanduar, sipas rastit, përfshirjen në to të konsideratave për peizazhin.

Neni 8

### Ndihma e ndërsjellë dhe shkëmbimi i informacioneve

Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë për të rritur efektivitetin e masave të marra në përputhje me nenet e tjera të kësaj Konvente, dhe veçanërisht:

a) t'i japin njëra-tjetrës asistencë teknike e shkencore në çështjet e peizazhit nëpërmjet grumbullimit e shkëmbimit të përvojës, dhe rezultateve të projekteve kërkimore;

b) të nxitin shkëmbimin e specialistëve të peizazhit, në veçanti për qëllimet e trajnimit dhe informimit;

c) të shkëmbejnë informacione për të gjitha çështjet që mbulojnë dispozitat e Konventës.

Neni 9

Peizazhet ndërkufitare. Palët do të nxisin bashkëpunimin ndërkufitar në nivel vendor dhe rajonal dhe, në rast se është e nevojshme, do të përgatitin dhe do të zbatojnë programe të përbashkëta për peizazhin.

Neni 10

### Monitorimi i zbatimit të Konventës

1. Komitetet kompetente ekzistuese të ekspertëve, të ngritura në bazë të nenit 17 të Statutit të Këshillit të Evropës, ngarkohen nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës që të përgjigjen për monitorimin e zbatimit të Konventës.

2. Pas çdo mbledhjeje të komiteteve të ekspertëve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i dërgojë Komitetit të Ministrave një raport për punën e kryer dhe funksionimin e Konventës.



3. Komitetet e ekspertëve i propozojnë Komitetit të Ministrave kriteret dhe rregullat për dhënien e një Çmimi për Peizazhin të Këshillit të Evropës.

#### Neni 11

#### Çmimi për Peizazhin i Këshillit të Evropës

1. Çmimi për Peizazhin i Këshillit të Evropës është një çmim nderi që mund t'u jepet autoriteteve vendore dhe rajonale, si dhe grupimeve të tyre, të cilat, si pjesë e politikës së peizazhit të një Pale të kësaj Konvente, kanë zbatuar një politikë apo masa për mbrojtjen, menaxhimin dhe/apo planifikimin e peizazhit të tyre, të cilat kanë rezultuar efektive për një kohë të gjatë dhe mund të shërbejnë si shembull për autoritete të tjera territoriale evropiane.

2. Aplikimet për Çmimin e Peizazhit të Këshillit të Evropës u dorëzohen nga Palët komiteteve të ekspertëve të përmendura në nenin 10. Autoritetet dhe grupimet vendore dhe rajonale ndërkuftare të interesuara mund të aplikojnë, me kusht që të menaxhojnë bashkërisht peizazhin në fjalë.

3. Me propozim të komiteteve të ekspertëve të përmendur në nenin 10, Komiteti i Ministrave përcakton dhe publikon kriteret për dhënien e Çmimit të Peizazhit të Këshillit të Evropës, miraton rregullat përkatëse dhe jep këtë Çmim.

4. Dhënia e Çmimit të Peizazhit të Këshillit të Evropës bëhet për të inkurajuar ata që e marrin çmimin që të sigurojnë mbrojtjen, menaxhimin dhe/apo planifikimin e qëndrueshëm të zonave të peizazhit përkatës.

#### KREU IV

#### KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 12

#### Lidhja me instrumentet e tjera

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë dispozita më të rrepta në lidhje me mbrojtjen, menaxhimin apo planifikimin e peizazhit që përmbajnë instrumentet e tjera detyruese kombetare apo ndërkombëtare ekzistuese apo të ardhshme.

#### Neni 13

#### Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të

Evropës. Ajo do t'i nënshtrohet procedurës së ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

2. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore pas datës në të cilën dhjetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u detyruar ligjërisht nga Konventa në përputhje me dispozitat e paragrafit të mëparshëm.

3. Në lidhje me çdo shtet nënshkrues që shpreh më pas pëlqimin e tij për të qenë i detyruar ligjërisht nga Konventa, ajo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

#### Neni 14

#### Aderimi

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund të ftojë Komunitetin Evropian dhe çdo shtet evropian joanëtar të Këshillit të Evropës, të aderojë në Konventë me një vendim të shumicës të parashikuar në nenin 20/d të Statutit të Këshillit të Evropës, dhe me votë unanime të shteteve palë që kanë të drejtën e pasjes së vendeve në Komitetin e Ministrave.

2. Për çdo shtet aderues apo për Komunitetin Evropian në rast aderimi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

#### Neni 15

#### Zbatimi territorial

1. Çdo shtet apo Komuniteti Evropian, në kohën e nënshkrimit apo kur depozitojnë instrumentin e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, mund të specifikojnë territorin apo territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Secila Palë, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në çdo datë të mëvonshme mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit



që pason skadimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 16

#### Denoncimi

1. Secila Palë, në çdo kohë, mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 17

#### Amendamentet

1. Secila Palë apo komitetet e ekspertëve të përmendura në nenin 10 mund të propozojnë amendamente për këtë Konventë.

2. Çdo propozim për amendament i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili ua komunikon shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, Palëve të tjera dhe çdo shteti evropian joanëtar që është ftuar të aderohet në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 14.

3. Komitetet e ekspertëve të përmendura në nenin 10 do të shqyrtojnë çdo amendament të propozuar, dhe do të paraqesin tekstin e miratuar me shumicën e tre të katërtave të përfaqësuesve të Palëve në Komitetin e Ministrave për miratim. Pas miratimit të tij nga Komiteti i Ministrave me shumicën e parashikuar në nenin 20/d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votë unanime të shteteve palë që kanë të drejtë të kenë vende në Komitetin e Ministrave, teksti do t'u transmetohet Palëve për pranim.

4. Për Palët që e kanë pranuar, çdo amendament hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore pas datës në të cilën tri shtete anëtare të Këshillit të Evropës e kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre. Për secilën Palë që e pranon atë

më pas, ky amendament do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason skadimin e një periudhe tremujore pas datës në të cilën kjo Palë ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e saj.

Neni 18

#### Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, çdo shtet apo Komunitetin Evropian që kanë aderuar në këtë Konventë, në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenet 13, 14, dhe 15;
- d) çdo deklaratë të bërë sipas nenit 15;
- e) çdo denoncim të bërë sipas nenit 16;
- f) çdo propozim për amendament, çdo amendament i miratuar sipas nenit 17 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;
- g) çdo akt, njoftim, informacion apo komunikim tjetër që lidhet me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Firence, më 20 tetor 2000, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëllorj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës, si dhe çdo shtet apo Komunitetin Evropian të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

**VENDIM**

**Nr. 59/2016**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË  
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË  
TRANSPORTIT DHE  
INFRASTRUKTURËS**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 9730, datë 7.9.2016, të Presidentit të Republikës,



KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9730, datë 7.9.2016, për shkarkimin e zotit Edmond Haxhinasto nga detyra e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 8.9.2016

VENDIM  
Nr. 60/2016

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË  
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË  
TRANSPORTIT DHE  
INFRASTRUKTURËS**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 9731, datë 7.9.2016, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9731, datë 7.9.2016, për emërimin e zotit Sokol Dervishaj në detyrën e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 8.9.2016

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë